



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 20.6.2022

**Lënda:** Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik në çështjen ankim kundër vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në seancën e datës 6.6.2022, bazuar në nenin F, pika 3, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 45-49 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të pranojë, në funksion të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, ankim kundër vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Rilinda Selimi, disa nga aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës<sup>1</sup>, të cilat i konsideroi të mjaftueshme për zgjidhjen e çështjes.

Komisioneri Publik, pas ballafaqimit të shkaqeve të ankimit të datës 12.2.2021, të konfirmuara me parashtrimet e Komisionerit Publik, të datës 28.4.2022 dhe 19.5.2022, përkundrejt parashtrimeve me shkrim dhe akteve të sjella të subjektit të rivlerësimit, të administruara nga Kolegji,<sup>2</sup> në cilësinë e provës, vëren se shkaqet e ankimit, të cilat lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e kontrollit të figurës, qëndrojnë dhe nuk arrihet të plotësohen së bashku kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Lidhur me provat e administruara nga Kolegji në cilësinë e provës, për secilin shkak ankimi të cilit ato u përkasin, Komisioneri Publik, konstaton se:

1. Lidhur me shkaqet ankimore referuar, si: (i) “Pika e karburantit Vlorë”, (ii) të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e pasurisë “Pika e karburantit Vlorë”

1.1 Komisioneri Publik, referuar akteve të administruara, në cilësinë e provës, kontrata të ngjashme, të listuara me numër rendor nga 1 deri në 7, në faqen 81 të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 22.4.2022, emërtuar “Lista e akteve shkresore”, gjen të pashëruar shkakun ankimor, si për sa i përket: (i) cilësimit si person tjetër të lidhur të z. \*\*\*.\*\*\* dhe mundësisë së bashkinvestimit me të ardhura të ligjshme, për shumën 101.000 euro, në këtë pasuri; (ii) mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur/bashkëshorti, për të mbuluar

<sup>1</sup> Sipas numërtimit, në inventarin e paraqitur nga subjekti, i referohen të gjitha akteve nga numri rendor 1 deri në 17, të listuara në f. 81 të parashtrimeve, si dhe aktet me numër rendor 103-104-105, f. 87-88 të tyre.

<sup>2</sup> Me vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit, të shpallur në seancën gjyqësore publike të datës 6.6.2021.

plotësisht me burime të ligjshme, vlerën 10.000 euro, sikurse trajtuar gjerësisht në ankim; si dhe (iii) marrëdhëniet e qirasë, të lidhura me këtë pasuri, të cilat shfaqin një karakter atipik.

**2.** *Lidhur me shkakun ankimor, Apartamenti me sipërfaqe 155 m<sup>2</sup> dhe 35 m<sup>2</sup> verandë, i ndodhur në \*\*\*, Tiranë, Komisioneri Publik, referuar akteve të administruara në cilësinë e provës, kontrata të ngjashme, të listuara me numër rendor nga 8 deri në 17, në faqen 81 të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 22.4.2022, emërtuar “Lista e akteve shkresore, gjen të pashëruar shkakun ankimor për situatat faktike të deklaruara nga subjekti, mbi vlerën dhe sipërfaqen e pasurisë në pronësi të subjektit dhe personit tjetër të lidhur.*

2.1 Subjekti, znj. Selimi, për këtë shkak ankimi, arriti të provojë se nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me ortakun/administratorin e shoqërisë “\*\*\* \*\*”.

**3.** *Lidhur me shkakun ankimor për vlerësimin e kriterit të figurës, Komisioneri Publik, referuar aktit të administruar në cilësinë e provës, listuar me numër rendor 103, në faqen 87 të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 22.4.2022, emërtuar “Lista e akteve shkresore, gjen të pashëruar shkakun ankimor mbi kontrollin e figurës, për sa i kohë i referohemi një vendimi gjyqësor jo të formës së prerë<sup>3</sup>, dhe, për më tepër, që nuk ndryshon kualifikimin e kontaktit të papërshtatshëm, vendosur në kontekstin kohor të periudhës së konstatimit dhe detyrimit për deklaram të kontaktit të papërshtatshëm.*

3.1 Gjithashtu, edhe akti i listuar me numër rendor 105<sup>4</sup>, në faqen 88 të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 22.4.2022, emërtuar “Lista e akteve shkresore”, nuk mund të ndryshojë përfundimin sa më lart cituar.

**4.** *Lidhur me shkakun ankimor mbi ekzistencën e mundshme të gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion provues, të listuar me numër rendor 104, në faqen 88 të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 22.4.2022, emërtuar “Lista e akteve shkresore”, dhe arriti të provojë se nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit.*

**5.** *Lidhur me shkaqet ankimore për: (i) pasuritë e luajtshme, automjete në përdorim të subjektit të rivlerësimit, automjeti Mini Cooper, me targë: \*\*\* dhe automjeti BMW, me targë: \*\*\*; (ii) burimet e ligjshme të investimit të ndërtesës 3-katëshe në \*\*\*, Fushë-Krujë, edhe pse nuk u administruan akte në gjykimin në Kolegj, ato nuk afektojnë në kërkimet e bëra për sa i përket arritjes së nivelit të besueshëm në vlerësimin e pasurisë apo nivelit të besueshëm në kontrollin e figurës, për sa arsyetuar sa më sipër.*

## **6. Kërkimi përfundimtar**

6.1 Duke përfunduar për sa parashtruar, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së, Komisioneri Publik vlerëson se:

6.2 Në referencë të analizës së provave/akteve të administruara në dosje të Komisionit, parashtrimeve dhe akteve/provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe të administruara nga trupi gjykues në cilësinë e provës, në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, në gjendjen që janë aktet, ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i

<sup>3</sup> Vendimi nr.\*\*\*, datë \*\*.3.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Vlorë nuk ka timbrin “vendimi ka marrë formë të prerë”.

<sup>4</sup> “Certifikata e Sigurimit të personelit” (CSP), datë \*\*.1.2021.

rivlerësimin nuk arrin një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe nuk arrin një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të figurës;

6.3 Bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimin, znj. Rilinda Selimi.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**